



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 8305/15 Prot

Tiranë, më 4. 12. 2023

Lënda: Njoftim lidhur me njohjen e aktit të zhvillimit të seancës dëgjimore për z. Agim Kullolli

PREFEKTURËS SË QARKUT FIER

BASHKISË FIER

NJËSISË ADMINISTRATIVE FIER 153

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, vendimit nr. 115/2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i ndryshuar, me urdhrin nr. 8305/6 prot., datë 20.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin dhe vlerësimin e veprimeve dhe të qëndrimit të nëpunësit civil, z. Agim Kullolli, specialist në Degën e Thesarit Fier.

Me shkresat nr. 8305/7 prot., datë 25.10.2023, nr. 8305/9 prot., datë 13.11. 2023 dhe nr. 8305/11 prot., datë 24.11.2023 është bërë njoftimi i z. Kullolli në rrugë postare dhe nëpërmjet komunikimit elektronik, në adresën agim_kullolli@yahoo.com.

Nga dokumentat e dorëzuara me postë (duke përfshirë edhe shkresat e njoftimit për zhvillimin e seancave dëgjimore), rezultojnë, nga shënimi i postierit, se z. Kullolli është larguar jashtë shtetit duke mos marrë dijeni për fillimin e ecurisë disiplinore, e për rrjedhojë nuk është paraqitur në asnjë nga seancat dëgjimore, të zhvilluara pranë institucionit tonë, për shqyrtimin dhe vlerësimin e veprimeve dhe të qëndrimit të tij.

Në kushtet kur, nga Posta Shqiptare janë kthyer, në mënyrë të përsëritur, zarfet me shënime "Larguar" dhe "Larguar jashtë shtetit", si dhe kur nëpërmjet postës elektronike nuk disponohet asnjë përgjigje nga z. Kullolli, në bazë të pikës "b" të nenit 162 të Kodit të Procedurave Administrative "Kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi", vendosëm njoftimin publik të zhvillimit të seancës dëgjimore, në një kënd

të posaçëm pranë institucionit tonë, si dhe në njësinë administrative, në bashkinë dhe prefekturën e qarkut, ku përfshihet adresa e vendbanimit e z. Kullolli.

Lidhur me sa më lart, gjeni kopje të aktit të sipërcituar për shpallje, në një afat 10 ditor, në këndin e institucionit tuaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Risena XHAJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 8305/ *14* Prot .

Tiranë, më *4*.12.2023

NJOFTIM

Z. AGIM KULLOLLI

Në zbatim të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Pjesa VII, neni 162, dhe referuar faktit se z. Agim Kullolli, nuk iu përgjigj shkresave të dërguara në adresën: Rruga "Jakov Mile", 01490115, Nd. 12, H. 12, Ap. 6, 9302, Fier, konkretisht:

- Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8305/7 prot., datë 25.10.2023, me lëndë " Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore",
- Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8305/9 prot., datë 13.11.2023, me lëndë " Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore",
- Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8305/11 prot., datë 24.11.2023, me lëndë " Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore",
- Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8305/13 prot., datë 4.12.2023, me lëndë " Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore",

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendosi të kryejë njoftimin publik për z. Agim Kullolli, si vijon:

Në mbështetje të nenit 57, pika 2, gërma ç të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr. 115/2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i ndryshuar, të urdhrit nr. 8305/6 prot., datë 20.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është ngritur Komisioni i Disiplinor për shqyrtimin dhe vlerësimin e veprimeve dhe të qëndrimit tuaj, lidhur me shkeljen e pretenduar ndaj jush.

Ju informojmë se ju mbartni detyrimin të paraqiteni në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, referuar faktit se ndaj jush ka nisur një procedurë disiplinore, për shkak të braktisjes së punës/mungesës së pajustificuar për periudhën nga data 5.6.2023 e në vijim.

Për sa më lart, në zbatim të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Pjesa VII, neni 162, ju informojmë se ky njoftim do të shpallet në :

- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al;
- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Njësinë Administrative Fier 153, ZGjC 4, ku rezulton i regjistruar z. Kullolli;
- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Bashkinë Fier;
- Faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Fier, <https://bashkiafier.gov.al/>;
- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Prefekturën e Fierit;
- Faqen zyrtare elektronike të Prefekturës së Fierit, <https://prefektifier.gov.al/>.

Njoftimi shpallet sot më datë 7.12.2023 dhe hiqet më datë 16.12.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Risena XHAJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 8305/____ Prot .
13

Tiranë, më 4/12, 2023

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e seancës dëgjimore

Z. AGIM KULLOLLI

Rr. "Jakov Mile" 01490115, Nd. 12; H. 12; Ap. 6; 9302
Fier

**Për dijëni: DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
ANËTARËVE TË KOMISIONIT**

Në bazë të kreut II, ndarja C, pika 4 të udhëzimit të DAP-it nr. 1/2014, nenit 16 kreu II të VKM-së 115/2014 *i ndryshuar*, ju njoftojmë se më datë 18.12. 2023, në orën 10:00, në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, do të mbledhet Komisioni Disiplinor, për zhvillimin e seancës dëgjimore lidhur me shkeljen e pretenduar ndaj jush, referuar nenit 57, pika 2, gërma ç, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" *i ndryshuar*, për braktisjen e punës/mungesës së pajustificuar për periudhën nga data 5.6.2023 e në vijim.

Në këtë seancë keni të drejtë të paraqiteni personalisht ose me përfaqësues ligjor. Keni të drejtë për të paraqitur pretendime me shkrim rreth shkeljes së pretenduar, për të paraqitur provat apo dëshmitarë, si dhe të inspektoni dosjen e procedimit.

Procedimi disiplinor vazhdon në mungesë, meqenëse pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme nëpunësi apo përfaqësuesi i tij nuk u paraqitën.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Risena XHAJA

